

20141133391

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14 dhe 97/14), në nenin 11 paragrafi (1) pika 14) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Pas pikës 14) shtohet pikë e re 15), si vijon:

"15) persona të cilët realizojnë të hyra nga puna e kryer fizike dhe/ose intelektuale, në bazë të marrëveshjes për veprë dhe/ose marrëveshjes autoriale ose marrëveshje tjetër me të cilën është përcaktuar kompensim për punë të kryer që në neto shumë është më i lartë nga shuma e rrogës minimale të përcaktuar me ligj".

Në paragrafin (2) pas numrit "9" shtohet presje ndërsa fjalët: "dhe 14" zëvendësohen me fjalët: "14 dhe 15".

Neni 2

Në nenin 28-a pas numrit "14" shtohen fjalët: "dhe 15".

Neni 3

Në nenin 118 paragrafi (1) fjalët: " dhe "14" zëvendësohen me fjalët: "14 dhe 15".

Neni 4

Në nenin 119 paragrafi (1) fjalët: "dhe 14" zëvendësohen me fjalët: "14 dhe 15".

Neni 5

Në nenin 125 paragrafi (4) pika 1) pas fjalës: "atë" shtohen fjalët: "edhe për personat për të cilët paguan kompensim në bazë të marrëveshjes për veprë dhe/ose marrëveshjes autoriale ose marrëveshje tjetër me të cilën është përcaktuar kompensim për punën e kryer që në neto shumë është më i lartë nga shuma e rrogës minimale të përcaktuar me ligj".

Në pikën 5) fjalët: "dhe 14" zëvendësohen me fjalët: "14 dhe 15 nëse kompensimi në bazë të marrëveshjes për veprë dhe/ose marrëveshjes autoriale ose marrëveshjes tjetër me të cilën është përcaktuar kompensim për punën e kryer që në neto shumë është më i lartë nga shuma e rrogës minimale të përcaktuar me ligj".

Neni 6

Pas nenit 132 shtohet nen i ri 132-a, si vijon:

"Neni 132-a

(1) Aktvendimet me të cilat është përcaktuar e drejta e sigurimit pensional dhe invalidor në mënyrë të obligueshme i nënshtrohen revizionit.

(2) Revizionin nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen Seksioni për revizion të aktvendimeve me të cilat përcaktohen të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor në Shërbimin Profesional të Fondit.

(3) Revizioni nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të aktvendimit.

(4) Fondi më afërsisht e rregullon mënyrën e kryerjes së revizionit sipas këtij neni.

(5) Për revizionin e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni, Fondi dorëzon raport mujor te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale".

Neni 7

Në nenin 185 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Fondi me akt të përgjithshëm i përcakton mënyrën dhe kushtet për vendosje në shtëpi dhe banesa banimi, funksionin dhe veprimtarinë e këtyre objekteve si dhe mënyrën dhe kushtet e punës së tyre."

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), si vijojnë:

"(3) Për vendosje në shtëpi dhe banesa banimi, vendos Komisioni i formuar nga drejtori i Fondit e i përbërë prej pesë anëtarëve prej të cilëve: dy përfaqësues nga Fondi, dy përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe një përfaqësues nga Ministria e Financave.

(4) Gjatë vendimmarrjes për vendosje në shtëpi dhe banesa banimi, Komisioni shfrytëzon aplikacion softueri për ndarje elektronike të shtëpive dhe banesave banimi, të përgatitur nga Fondi".

Neni 8

Në nenin 199 pika 1 pas fjalëve "ata" shtohen fjalët: "dhe për personat për të cilët paguan kompensim në bazë të marrëveshjes për vepër dhe/ose marrëveshjes autoriale ose marrëveshjes tjetër me të cilën është caktuar kompensim për punën e kryer që në shumë neto është më i lartë nga shuma e rrogës minimale të përcaktuar me ligj."

Në pikën 6 pika në fund të fjalisë ndryshohet me pikëpresje.

Pas pikës 6 shtohet pikë e re 7, si vijon:

"7. personat nga neni 11 paragrafi (1) pika 15 të këtij ligji nëse kompensimin në bazë të marrëveshjes në vepër dhe/ose marrëveshjes autoriale ose marrëveshjes tjetër me të cilën është përcaktuar kompensim për punën e kryer që në shumë neto është më i lartë nga shuma e rrogës minimale e përcaktuar me ligj i paguan person fizik - vetë për vetë".

Neni 9

Pas nenit 207 shtohet nen i ri 207-a, si vijon:

"Neni 207-a

(1) Fondi përpilon pasqyrë me të dhëna nga evidenca amë e të siguruarve për çdo të siguruar i cili është i paraqitur në sigurim të obligueshëm social dy herë në vit e më së voni deri më 15 shkurt dhe më së voni deri në 15 korrik çdo vit. Pasqyra përmban: të dhëna për regjistrime dhe çregjistrime nga sigurimi; të dhëna për stazhin pensional; të dhëna për periudha të sigurimit; të dhëna për orë të punës, përkatësisht të sigurimit; të dhëna për rroga, përkatësisht baza të sigurimit; të dhëna për stazh të sigurimit i cili llogaritet me kohëzgjatje të zmadhuar, të dhëna për periudha të përfunduara të sigurimit të përfunduara në shtet tjetër.

(2) Fondi në afat prej tri ditësh propozimin nga paragrafi (1) i këtij neni e dorëzon te obliguesi për paraqitjen e të dhënave, personi i vetëpunësuar ose bujku individual në letër ose në formë elektronike në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.

(3) Pas marrjes së pasqyrës nga paragrafi (1) i këtij neni, punëdhënësi i cili është obligues për paraqitjen e të dhënave, është i obliguar që menjëherë të siguroarit t'i dorëzojë pasqyrë në letër ose në formë elektronike në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.

(4) Fondi është i obliguar që të sigurojë formë elektronike dhe qasje nëpërmjet të internetit të të dhënave nga evidenca amë e të siguruarve që do të jepet pas pëlqimit paraprak me shkrim nga i siguruari.

(5) Fondi më afërsisht i rregullon formën dhe përmbajtjen e pasqyrës së të dhënave nga evidenca amë e të siguruarve".

Neni 10

Në nenin 221 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Gjorbë në shumë prej 2 000 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje punëdhënësit nëse nuk vepron në pajtim me nenin 207-a paragrafin (3) të këtij ligji".

Në paragrafin (5) pas numrit "(6)" shtohen fjalët: "edhe nenet 207-a paragrafët (1) dhe (5) dhe 132-a të këtij ligji".

Paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij neni bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6).

Neni 11

Aktet nënligjore miratimi i të cilave është përcaktuar me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 13

Ky lig hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa dispozitat e neneve 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 8 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2015, dispozitat e nenit 7 paragrafët (3) dhe (4) do të fillojnë të zbatohen nga 1 qershori 2015, dispozitat e nenit 9 paragrafët (1), (2) dhe (3) do të fillojnë të zbatohen nga 1 shkurti 2015, përveç paragrafit (4) i cili do të fillojë të zbatohet nga 1 qershori 2015.